



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:274202

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05388052

KF.nr.582/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit DPT “Ymeri Commerce” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur në rigjykim dhe rivendosje sipas aktvendimit K.DH.SH.II.nr.259/22 të datës 12.07.2023 të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, me bazë ligjore anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të pronarit të paditësit Islam Ymeri dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur XH.K., me datë 20.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit DPT “Ymeri Commerce” me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET aktvendimi nr.06.1.4/31 i datës 09.02.2010 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatën e Apelit, me datë 26.06.2013, ka iniciuar kontestin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, ndaj aktvendimit A.nr.79/2010 -DK të datës 03.04.2013, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar, të anulohet aktvendimi i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime si dhe ti kompensohen shpenzimet e procedurës sipas vlerësimit të gjykatës.

Paditësi si në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor e konteston ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Procedurës Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Duke shtuar se aktvendimi i kontestuar është i pabazuar, se nuk ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 275 pika (b) të Kodit Doganor dhe të akcizave, sepse sipas kësaj dispozite kundërvajtje administrative kryen personi në qoftë se e sjellë apo tenton ta sjellë mallin në mënyrë të fshehur në Kosovë, përkatësisht e nxjerrë apo tenton ta nxjerrë mallin, në mënyrë të fshehur jashtë Kosovës, ngase nuk e ka kaluar kufirin, nuk e ka sjellë mallin në Kosovë, të njëjtin e ka ble në tregun me shumicë në Prishtinë, e i cili fakt vërteton se nuk ka kryer kundërvajtje doganore e cila i vihet në barrë, këtë fakt e vërteton edhe vlera e mallit të sekuestruar e cila kap shumën prej 86.94 euro, të cilat janë pije freskuese. Duke propozuar ë të aprovohet kërkesë padia si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi i kontestuar si jo i ligjshëm. Po ashtu edhe në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se në vitin 2008 pasi është larguar nga puna nga Fabrika e Bukës kishte hapur një dyqan të vogël për të siguruar jetesën për familjen.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 17.05.2015 ka deklaruar se nuk mund të jap përgjigje në padi për shkak të përfundimit të punës së Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, përkatësisht bartjes së kompetencave në Gjykatën Themelore -Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 30.01.2024 përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës i ka kundërshtuar pretendimet e paditësit të shprehura në ankesë-padi, me propozim që gjykata të refuzojë në tërësi si të pabazuar, sepse siç është theksuar në aktvendimin kontestues ndaj paditësit është udhëhequr procedurë administrative kundërvajtëse dhe është konstatuar se paditësi ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 275 pika b i KDA-së. Në aktvendimin e kundërvajtjes doganore theksohet data e kontrollit, mënyra e kryerjes dhe konstatimi se paditësi me veprimet e tij ka kryer kundërvajtje doganore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzojë padinë dhe të lë në fuqi vendimin kontestues.

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin AA.nr.303/2014 të datës 14.03.2018 e ka aprovuar padinë e paditësit ashtu që ka anuluar Aktvendimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime A.nr.79/2010-DK i datës 03.04.2013, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, duke e udhëzuar gjykatën që në rivendosje të vlerësoj ligjshmërinë e organit të shkallës së parë-Doganës së Kosovës me nr.06.1.4 nr.31 i datës 09.02.2010.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal me aktvendimin A.nr.768/18 të datës 21.09.2020 duke vepruar në ri procedurë sipas Aktgjykimit AA.nr.303/2014 të datës 14.03.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ka ndërprerë procedurën gjyqësore në konfliktin administrativ A.nr.768/18, sipas padisë së paditësit, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për shkak të parashkrimit të kundërvajtjes administrative doganore.

Ndaj aktvendimit të lartcekur e paditura ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, lënda është transferuar nga Gjykata e Apelit për në Gjykatën Komerciale të Kosovës, Dhomave të Shkallës së dytë, për shqyrtim të mëtejshëm në bazë të kompetencës lëndore, dhe ka marrë numrin K.DH.SH.II.nr.259/22.

Gjykatat Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së dytë, me datë 12.07.2023 ka marr aktvendim me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së parë.

Gjykata duke vepruar në ri procedurë sipas aktvendimit K.DH.SH.II. nr.259/22, në seancën e datës 30.01.2024, ka shqyrtuar këtë konflikt tregtar administrativ gjyqësor në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik, ka administruar provat relevante dhe atë: Aktgjykimin e Apelit nr .AA 303/2014, Aktvendimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime A.nr.79/2010-DK të datës 03.04.2013, Kërkesnë për rishqyrtimin e aktvendimit të datës 12.01.2010, Aktvendimin nr. 06.1.4/31 të datës 09.02.2010, Aktvendimi nr. 08/589 të datës 21.12.2009, Ankesë drejtuar Bordit të datës 12.03.2010, Procesverbalin mbi kundërvajtjen doganore nr. i referencës 68/2009, Vërtetimi mbi konfiskimin e mallrave i datës 01.12.2009 , Aneks 000787, Raport pune dt. 01.12.2009, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit AA.nr.103/2013, Përgjigje në padi e datës 17.12.2015, Vlerësim nga Dogana e Kosovës 03.3.4 nr.447, Deklaratë e paditësit me shkrim dore e datës 03.12.2009.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ rezulton se e paditura Dogana e Kosovës-Sektorit për Rishqyrtimin e vendimeve, me aktvendimin e kontestuar me nr.06.1.4 nr.31 i datës 09.02.2010, e ka refuzuar ankesën e tatimpaguesit këtu paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit me nr.08/589 të datës 21.12.2009, të lëshuar nga Komisioni për Kundërvajtje Doganore,

me të cilin vendim paditësi është shpallur përgjegjës për kryerje të kundërvajtjes doganore nga neni 275 pika b) e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109 dhe është ndëshkuar me gjobë administrative në shumë prej 5,000.00€, si dhe i është konfiskuar malli në vlerë prej 86,94 €, për shkak se për të njëjtin mall paditësi nuk ka poseduar mbulesë të dokumentacionit.

Nga aktvendimi i kontestuar gjykata vëren se ai përmban të meta të tilla, për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla konsistojnë në atë se arsyetimi i vendimit kontestues përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket bazës ligjore dhe faktike, mbi të cilën paditësi është shpallur përgjegjës për kryerje të kundërvajtjes doganore nga neni 275 pika b) e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Në këtë drejtim gjykata thekson se paditësi në ankesën e ushtruar tek e paditura e ka ngritur pretendimin se aktvendimi me nr.08/859 i datës 21.12.2009, i nxjerr nga Komisioni për Kundërvajtje Doganore, nuk përmban asnjë fakt i cili do të dëshmonte se malli i konfiskuar është sjell në mënyrë të fshehur në Kosovë, nuk është përcaktuar koha e përafërt e sjelljes së atij malli, nuk janë përcaktuar veprimet se gjoja malli është sjell në mënyrë të fshehtë, nga ana tjetër e paditura në vendimin e kontestuar në vend që ti shqyrtoj këto pretendime në raport me dispozitat ligjore, në vendimin e kontestuar ka dhënë arsyetimin se gjatë kontrollit në lokalitetin e paditësi me datë 01.12.2009 ka konstatuar se subjekti ka sjell në mënyrë të fshehur në Kosovë mallin pije joalkoolike në vlerë 86,94 €, duke mos i respektuar dispozitat e aplikueshme në fuqi, pasi që gjatë kontrollit nga zyrtarët doganor është verifikuar se për këtë sasi të mallit nuk kishte mbulesë dokumentacioni dhe se i njëjti mall ishte dedikuar vetëm për tregun e Serbisë, andaj Komisioni ka vlerësuar se subjekti mallin kontestues e ka sjell në mënyrë të fshehur në Kosovë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 275 pika b) e KDAK-së.

Gjykata vlerëson se e paditura duke vepruar në këtë mënyrë nuk ka vërtetuar në pikat esenciale faktet vendimtare me rëndësi, sikurse edhe nga faktet e vërtetuar ka nxjerr konkluzion jo të drejt në pikëpamje të gjendjes faktike, siç edhe në procedurë administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, dhe për pasoj edhe e drejta materiale nuk është aplikuar në mënyrë të drejtë.

Në nenin 275 pika b) të KDAK-së është sanksionuar si kundërvajtje administrative doganore në rast se ” *Personi juridik apo fizik: Në qoftë se, e sjellë apo tenton ta sjellë mallin, në mënyrë të fshehur në Kosovë, përkatësisht e nxjerrë apo tenton ta nxjerrë mallin, në mënyrë të fshehur jashtë Kosovës*”.

Në kuptim të kësaj dispozite ligjore gjykata vlerëson se e paditura në rastin konkret me asnjë provë nuk ka provuar se në veprimet e paditësit, përkatësisht pas kontrollit të ushtruar në lokalit të tij me datë 01.12.2009, janë plotësuar elementet e kundërvajtjes doganore, nga neni 275 pika b) e KDAK-së, pasi është gjetur malli-pije joalkolike në vlerë prej 86.94 € për të cilin subjekti nuk posedonte dëshmi mbi prejardhjen e mallit, sepse sipas vlerësimit të gjykatës për tu kryer kundërvajtja doganore nga ky nen, e paditura do të duhej të provonte kohën se kur malli – pijet janë sjellë apo është tentuar të sillen në mënyrë të fshehtë në Kosovë nga paditësi, gjë të cilën ka dështuar ta bëjë.

Gjykata nuk e konteston të drejtën e Doganës së Kosovës për të ushtruar kontroll lidhur me zbatimin e legjislacionin doganor në fuqi sipas nenit 19 dhe 259 të KDAK-së, mirëpo gjykata vlerëson se e paditura në këtë rast ka bërë përshkrimin për elementet e kundërvajtjes doganore i cili nuk lidhet fare me veprën kundërvajtjese nga neni 275 pika b) e KDAK-së.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ, për arsye se, ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe se arsyetimi i të paditurës se malli lëndor i cili është gjetur në lokalit të subjektit është mall i dedikuar vetëm për tregun e Serbisë dhe nga ky fakt subjekti është dashur të dijë se malli të cilin e ka blerë është mall i kontrabanduar dhe se pretendimi i subjektit nuk mund të pranohet pasi që sipas nenit 277 të KDA-së thuhet se *Çdokush që e pranon mallin për të cilin e ka ditur, apo nga rrethanat e rastit ka mund të dijë se me të është kryer kundërvajtje nga neni 275, 276 dhe 277 të këtij Kodi, do të gjobitet, sikur vetë të kishte kryer kundërvajtjen, me të njëjtën gjobë të përcaktuar për kryesin e kundërvajtjes*. Shtjellimi më tej i çështjes tregon një kontradiktë midis gjendjes faktike dhe interpretimit të aktvendimit që ka shpallur paditësin përgjegjës. Nuk është e qartë nëse përgjegjësia mbështetet në nenin 275 apo 277 të KDAK-së. Gjithashtu, përfundimi se subjekti nuk ka arritur të vërtetojë origjinën e mallit dhe se malli është sjellë fshehurazi në Kosovë, duke shkelur nenin 275 pika b) të KDAK-së, nuk duket të mbështetet mjaftueshëm nga provat e disponueshme.

Mungesa e dokumentacionit mbi prejardhjen e mallit e konstatuar nga e paditura në vlerësimin e gjykatës nuk do të thotë se plotësohen elementet dhe tiparet e kundërvajtjes doganore nga neni 275 pika b) e KDAK-së dhe kjo gjë vërehet qartë nga sanksionimi i kundërvajtjes doganore në këtë nen, por në këtë rast eventualisht do të mund të plotësoheshin elementet tjera të kundërvajtjes doganore

nga neni 200 i KDAK-së, çka e paditura duhet të ketë parasysh me rastin e trajtimit të serishëm të lëndës në ri procedurë e gjithashtu të ketë parasysh edhe dispozitat ligjore nga neni 306 i KDAK-së dhe dispozitat e nenit 9 të Ligjit me nr.04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, sipas të cilit ligj dënimi minimal me të holla për kundërvajtje doganore ka pësuar ndryshim, nga shuma prej 5,000.00€ në shumën prej 500.00€.

Prandaj, gjykata e obligon të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje, të shqyrtoj edhe njëherë pretendimet ankimore të paditësit të parashtruara tek e paditura dhe për të njëjtat të jep vlerësim të bazuar në ligj dhe në faktet e konstatuara me rastin e realizimit të kontrollit tek paditësi. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga kontrolli i realizuar tek paditësi dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet procedura kundërvajtëse, duke pasur parasysh edhe praktiken doganore në rastet e ngjashme.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, konform nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të cekurat më lart, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.582/23, datë 28.02.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.